

CILI ËSHTË KODI I IDENTIFIKIMIT TATIMOR

Kodi Tatimor është një kod me 16 germa, i përbërë nga shkronja dhe numra që karakterizojnë të dhënat personale të qytetarit:

- ✓ 3 shkronjat e para për mbiemrin
- ✓ 3 shkronjat e dyta për emrin
- ✓ 2 numrat e parë janë dy shifrat e fundit të vitit të lindjes
- ✓ germa e nëntë është një shkronjë që përfaqëson muajin e lindjes
- ✓ dy numrat e që ndjekin janë dita e lindjes (për gratë rritet me 40 njësi)
- ✓ germat nga 12 deri në 15 tregojnë bashkinë italiane ose Vendin e huaj të lindjes
- ✓ germa e fundit llogaritet automatikisht nga sistemi.

PËR ÇFARË DUHET

Kodi tatimor identifikon një qytetar në marrëdhënie me Administratën Publike dhe është i nevojshëm për t'u regjistruar në Autoritetet shëndetësore lokale (AsI) dhe për të bërë zgjedhjen e mjekut. Vetëm ai i lëshuar dhe i vërtetuar nga Agjencia e të Ardhurave është i vlefshëm dhe nuk ka datë skadence. Dërgohet me postë të zakonshme:

- ✓ në adresën e vendbanimit, për shtetasit rezidentë
- ✓ në vendbanimin tatimor të komunikuar nga shtetasi në momentin e kërkesës, për jorezidentët.

PUBLIKIMI I BËRË NGA AGJENCIA E TË ARDHURAVE SEKTORI I KOMUNIKIMIT ZYRA E KOMUNIKIMIT INSTITUCIONAL

Përgjegjës Sektori: **Sergio Mazzei**

Përgjegjëse e zyrës: **Cristiana Carta**

Projekti dhe kordinimi editorial:
Paolo Calderone,
Giovanni Maria Liprandi

Projekti grafik:
Stacioni grafik - Claudia Iraso

Në bashkëpunim me
Divizionin e Shërbimeve

KODI I IDENTIFIKIMIT
TATIMOR
PËR TË
HUAJTI

KODI I IDENTIFIKIMIT TATIMOR PËR QYTETARËT E HUAJ (TË SHTETEVE JO PJESËTARE TË BE-SË)

Shtetasve të huaj që mbërrijnë në Itali, kodi tatimor i jepet:

- ✓ nga **Sporteli unik për Imigracionin**, i pranishëm në çdo Prefekturë dhe përgjegjës për dhënien e lejeve të hyrjes për shtetasit e huaj që kërkojnë leje qëndrimi për punësim ose bashkim familjar
- ✓ nga **Kuestura**, zyra e Policisë së Shtetit, për shtetasit e huaj që kërkojnë lloje të tjera leje qëndrimi.

Sporteli unik për Imigracionin jep një kod të përkohshëm numerik tatimor. Në momentin e lëshimit të lejes së qëndrimit, shtetasi i huaj merr atë përfundimtar (të përbërë nga shkronja dhe numra). Kushdo që i drejtohet Kuesturës për të kërkuar leje qëndrimi, merr menjëherë kodin tatimor përfundimtar.

Nëse dy ose më shumë persona kanë të dhëna që gjenerojnë të njëjtin kod tatimor, Sporteli unik për Imigracionin ose Kuestura ftojnë qytetarin të shkojë pranë çdo zyre të Agjencisë së të Ardhurave, e cila pas verifikimit do të japë kodin tatimor përfundimtar.

SHTETASIT E HUAJ QË KËRKOJNË MBROJTJE NDËRKOMBËTARE

Për shtetasit e huaj që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, kodi tatimor i jepet nga Kuestura/Policia Kufitare në momentin e kërkesës. Nëse dy ose më shumë persona kanë të dhëna personale që gjenerojnë të njëjtin kod tatimor,

Kuestura i jep qytetarin një kod të përkohshëm tatimor dhe e fton të kontaktojë çdo zyrë të Agjencisë së të Ardhurave që lëshon atë përfundimtar. Me kodin e përkohshëm tatimor, qytetari mund të regjistrohet në ASL dhe të bëjë zgjedhjen e mjekut.

TË MITURIT E HUAJ TË PARREGULL OSE TË PASHOQËRUAR

Për të miturit e huaj të parregullt ose të pashoqëruar, kodi tatimor caktohet nga Agjencia e të Ardhurave me kërkesë të strukturës së Asl që kërkohet për regjistrimin e të miturit në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar. ASL i komunikon kodin tatimor kujtdo që ka përgjegjësi prindërore ose drejtuesit të strukturës që strehon të miturin.

REFUGJATËT UKRAINAS (procedurë e veçantë e pritjes)

Qytetarët ukrainas që kërkojnë mbrojtje të përkohshme marrin kodin përfundimtar tatimor nga Kuestura kur paraqesin kërkesën për leje qëndrimi të përkohshëm.

Vetëm nëse dy ose më shumë persona kanë të dhëna personale që gjenerojnë të njëjtin kod tatimor, Kuestura i jep shtetasit një kod të përkohshëm numerik tatimor dhe e fton të kontaktojë çdo zyrë të Agjencisë së të Ardhurave për nxjerrjen e kodit tatimor përfundimtar.

ATA QË BANOJNË RREGULLISHT NË ITALI PA KOD TATIMOR

Të huajt që banojnë rregullisht në Itali, por nuk kanë ende një kod tatimor, mund ta kërkojnë atë në çdo zyrë të Agjencisë së të Ardhurave.

Kërkesa duhet të jetë e motivuar dhe e shoqëruar me një nga dokumentet e mëposhtme:

- ✓ leje qëndrimi të vlefshme
- ✓ pasaportë të vlefshme, me vizë përkatëse (kur kërkohet), ose një dokument tjetër të njohur nga autoritetet italiane
- ✓ vërtetim identiteti të lëshuar nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore në Itali, të vendit të origjinës
- ✓ Kartë identiteti italiane.

Për të kërkuar kodin tatimor, është e nevojshme të paraqitet formulari AA4/8, i plotësuar dhe i nënshkruar, si dhe të tregohet një dokument identiteti i vlefshëm, ndër ato të renditura më sipër. Modeli dhe udhëzimet për plotësimin e tij gjenden në faqen “Modeli dhe udhëzimet AA4/8” të faqes së internetit të Agjencisë së të Ardhurave.

QYTETARËT E BE-SË (VENDET E BE-SË)

Qytetarët e BE-së që synojnë të qëndrojnë në Itali mund të kërkojnë kodin tatimor duke paraqitur modeli AA4/8 pranë një zyre territoriale të Agjencisë së të Ardhurave. Kërkesa duhet të jetë e motivuar dhe e shoqëruar me një dokument të vlefshëm (pasaportë ose kartë identiteti e vlefshme për daljen nga territori).

Kodi tatimor mund të kërkohet edhe nga përfaqësia konsullore italiane e pranishme në vendin e origjinës së shtetasit.

Qytetarët e BE-së mund të përdorin Shërbimin Shëndetësor Kombëtar me kartën shëndetësore të lëshuar nga vendi i tyre i banimit.

(TEAM - Karta Evropiane e Sigurimit Shëndetësor).